

Për: Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës
Pallati i Drejtësisë - Lagjja “Prishtina e Re”
10000 Prishtinë, KOSOVË

Nga: Organizata GERMIN
Rr. “Tringë Smajli”, nr. 48
10000 Prishtinë, KOSOVË

4 nëntor 2019

ANKESË

RE: Ndaj vendimit Anr. 382/2019, të datës 03.11.2019, të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Palët përgjegjëse: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP); Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

Përshkrimi i rastit:

Me datë 03.11.2019, Organizata GERMIN ka pranuar vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa lidhur me ankesën/apelin Anr. 382/2019 për moszbatimin e plotë të aktgjykimit A.A.UZH.nr. 20/2019 të Gjykatës Supreme nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Sipas këtij vendimi, PZAP hudh si të palejuar apelin në fjalë duke vlerësuar se *“nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni të bëj vlerësimin rreth zbatueshmërisë së Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme”* dhe se *“paneli vendos vetëm ndaj vendimeve të KQZ-së ashtu siç parashihet me nenin 122 paragrafi 1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës”*.

Vëzhguesit e akredituar të GERMIN, gjatë vëzhgimit të procesit të verifikimit dhe numërimit të pakove me fletëvotime të cilat kanë ardhur përmes postës pas datës 5 tetor, kanë vërejtur se KQZ nuk po e zbaton plotësisht vendimin A.A.UZH.nr. 20/2019 të Gjykatës Supreme, duke mos i procesuar fare 1,806 pako me fletëvotime përmes postës të cilat kanë arritur mes datës 11 tetor 2019 (ditën kur është ushtruar ankesa ndaj Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e cila ka sjellë deri tek vendimi A.A.UZH.nr. 20/2019 i Gjykatës Supreme për pranueshmërinë e fletëvotime të ardhura me postë pas ditës së zgjedhjeve) dhe deri më datën 17 tetor 2019. 1,806 pakot e paprocesuara të fletëvotimeve nga bashkëqytetarët tanë që jetojnë jashtë vendit janë refuzuar pa kaluar asnjë procedurë verifikimi nga ana e Sekretariatit të KQZ-së, edhe pse të njejtat janë nisur si dërgesa postare para afatit përfundimtar për dërgimin e votave përmes postës të vendosur nga KQZ-ja, përkatësisht nga data 19 shtator deri më datën 5 tetor 2019, gjë që mund të vërtëtohet në bazë të vulës postare në datën e nisjes. Gjithashtu, 1,806 pakot në fjalë kanë ardhur në KQZ përpara se të niste verifikimi dhe numërimi i 4,639 pakove të tjera të fletëvotimeve që ishin objekt i ankesës së parë të LVV-së, çka do të thotë se përfshirja në numërim e këtyre 1,806 pakove nuk do të kishte ndikuar dhe as vonuar procedimin e pakove të tjera. Mostrajtimi i këtyre pakove të fundit nga KQZ, bie në kundërshtim me aktgjykimin e Gjykatës Supreme A.A.UZH.nr. 20/2019 të datës 30.10.2019, si dhe me aktgjykimin më të hershëm të kësaj Gjykate, A.A.-UZH.nr. 19/2019 të datës 25.10.2019. KQZ, duke mos trajtuar këto pako, ka vendosur në heshtje refuzimin e tyre rrjedhimisht edhe moszbatimin e vendimeve të Gjykatës Supreme.

Arsyetim:

Ankesa është e bazuar në nenin 118.4 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (tutje: Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme), dhe në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit Nr. 02/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me të cilin parashikohet se mund të apelohej vendimi i PZAP në Gjykatën Supreme, brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa 5.000 euro, ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Në këtë drejtim, mosnumërimi i 1806 pakove me fletëvotime nga ana e KQZ-së cenon të drejtat themelore, përkatësisht të drejtat zgjedhore, të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për sa i përket vlefshmërisë së votave me postë të ardhura pas afatit ligjor dhe të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr. 03/2013, Gjykata Supreme përmes aktgjykimit A.A.UZH.nr. 19/2019 dhe aktgjykimit A.A.UZH.nr. 20/2019 ka vendosur qartë katër parime themelore për trajtimin e votave të ardhura me postë. Këto parime janë si në vijim:

1. *“Duke pasur parasysh nenin 127.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili parashikon se, në qoftë se ankesa e dërguar me anë të postës me letër rekomande apo në rrugë telegrafike, dita e dorëzimit në postë konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatën të cilës i është drejtuar”.* Sipas këtij parimi të aktgjykimit AA.UZH.nr 19/2019 të Gjykatës Supreme, të gjitha pakot me fletëvotime nga jashtë, përfshirë edhe këto 1806 të fundit, të cilat janë nisur me postë mes datave 19 shtator dhe 5 tetor 2019, janë të vlefshme.

Rrjedhimisht, sipas arsytimit të kësaj Gjykate, edhe 1806 pakot në diskutim “*duhet të trajtohen sikur kanë arritur në KQZ brenda afatit të pranueshëm*” dhe duhet t’i nënshtrohen të njëjtit proces të verifikimit dhe numërimit, në mënyrë të barabartë me të tjerat.

2. Gjykata ka konstatuar se kufizimi ligjor i arritjes së votave nga jashtë përbën shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zbatueshmëria e së cilës garantohet nga neni 22 i Kushtetutës së Kosovës. Në këtë drejtim, Aktgjykimi A.A.UZH.nr. 20/2019 i Gjykatës konstaton se “*neni 96 par. 3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe neni 4 par. 4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 janë në kolizion me nenin 3 të Protokollit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili përfshin të drejtën për zgjedhjet e lira, dhe në rastin konkret votuesit pa fajin e tyre ishin privuar nga mundësia për të shprehur mendimin e tyre në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës, votuesve u është mohuar veti thelbi i së drejtës për të votuar, siç garantohej nga neni 3 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*” Prandaj, përderisa mos-shqyrtimi i 1806 pakove në diskutim nga ana e KQZ-së është bazuar pikërisht në nenin 96, par. 3 i LZP-së dhe nenin 4, par. 4 të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013, ky mos-shqyrtim bie në kundërshtim të plotë me Aktgjykimin A.A.UZH.nr. 20/2019 të kësaj Gjykate.
3. Sa i përket mosekzistencës, gjoja, të një vendimi të marrë nga ana e KQZ-së për votat në fjalë, edhe ky argument është i paqëndrueshëm sipas një tjetër parimi të Gjykatës Supreme: që mosnumërimi i votave përbën në vetvete një vendim të marrë në heshtje. Në këtë drejtim, aktgjykimin AA.UZH.nr 19/2019 ka konstatuar si në vijim: “*Gjykata konkludon se me këtë veprim (duke aluduar mungesën e vendimmarrjes) KQZ-ja në mënyrë të heshtur ka marrë vendim që të mos numëroj këto dërgesa*”. Prandaj pretendimi i PZAP-së se nuk ka jurdiksion të vendosë për zbatueshmërinë e Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, por vetëm për vendimet e KQZ-së siç parashihet me 122, par. 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke aluduar që nuk ka vendimmarje nga ana e KQZ-së në këtë çështje, e shpërfill edhe këtë parim të Gjykatës Supreme.
4. Gjithashtu, në aktgjykimin e saj më të fundit (A.A.UZH.nr. 20/2019), Gjykata Supreme ka arsyetuar se numërimi i 4639 pakove që ishin objekt i atij rasti, duhej të kryhej, për shkak se “*procesi i numërimit të fletëvotimeve ka qenë në vazhdim e sipër dhe kjo [arritje me vonesë e pakove] nuk kishte për të ndikuar në rregullsinë e procesit të numërimit të fletëvotimeve*”. Në të njëjtën mënyrë dhe për të njëjtën arsye, përfshirja e 1806 pakove të fundit “*nuk kishte për të ndikuar në rregullsinë e procesit të numërimit të fletëvotimeve*”, përderisa ato pako kishin ardhur të gjitha përpara se të fillonte verifikimi dhe numërimi i 4639 pakove të tjera, më 31 tetor 2019. Rrjedhimisht, në bazë të arsytimit të kësaj

Gjykate, edhe 1806 pakot e mbetura në diskutim duhet të verifikohen dhe të numërohen, sidomos duke marrë parasysh se numërimi i tyre nuk do të kërkonte as një ditë të plotë, në qoftë se KQZ i procedon me të njëjtën shpejtësi me të cilën i ka proceduar 4639 pakove të tjera, të cilat janë verifikuar dhe numëruar plotësisht brenda dy ditëve.

Në këtë mënyrë, PZAP, duke refuzuar ankesën e organizatës GERMIN dhe duke mos urdhëruar procesimin e 1,806 pakove të fundit të nisura me postë përpara datës së zgjedhjeve, ka shpërfillur plotësisht, dhe pa asnjë shpjegim, katër parimet e lartcekura që janë shpalosur qartë në dy aktgjykime të Gjykatës Supreme.

Përveç kësaj, gjatë procedimit të këtij rasti nga ana e PZAP-it, KQZ ka ngritur një çështje tjetër që kërkon të adresohet shprehimisht. PZAP, duke qenë se e ka trajtuar ankesën tonë si apel, referuar nenit 3, par. 8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka kërkuar përgjigje në ankesë nga pala përgjegjëse, përkatësisht Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në përgjigjen në ankesë, KQZ ka theksuar se “në bazë të nenit 119 par. 1, ku thuhet se *“personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionint të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas ligjit, ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë anknesë pranë PZAP-së”*. Më tutje, KQZ pretendon se ankuesi, përkatësisht Organizata GERMIN nuk është palë në procedurë, dhe nuk iu është shkelur asnjë e drejtë ligjore”.

Ky pretendim është i pabazë për arsyet si në vijim:

1. OJQ GERMIN është e regjistruar në Kosovës sipas Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, me Nr. 5115036-8, që nga data 15.05.2014. GERMIN në qëllimet e organizatës, të përcaktuar në nenin 3 të statutit, synon lehtësimin e lidhjeve të pjesëtarëve të diasporës me shtetin amë dhe avokimin për avancimin e të drejtave dhe kontributit të tyre në atdhe.
2. Lidhur me çështjen në fjalë, GERMIN ka hartuar dhe avokuar rekomandime të politikave për përmirësimin e procesit të votimit jashtë vendit dhe ka qenë pjesë e grupit punues të Komisionit të Kuvendit për Legjislacion për hartimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovë, projektligj i cili është miratuar në Komision dhe i është përcjellë Kuvendit të Kosovës për votim. GERMIN që nga Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2017 ka nisur kampanjën “Vota e Diasporës”, e cila synon që të sensibilizojë qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë vendit për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhjet në Kosovë.

3. Gjithashtu, GERMIN është organizata e parë joqeveritare që ka vëzhguar procesin e pranimit, verifikimit dhe numërimit të votave të ardhura përmes postës në adresë të KQZ-së, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.
4. Pretendimi i KQZ-së se GERMIN nuk është palë në këtë procedurë është i paqëndrueshëm edhe për faktin se votuesit të cilët kanë dërguar fletëvotimet përmes postës brenda afatit ligjor, edhe po të duan nuk kanë mundësi të ankohen për shkelje të të drejtave zgjedhore siç përcakton Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për shkak të pamundësisë së konfirmimit të arritjes dhe pranimit të votave të tyre nga ana e KQZ-së.
5. Më tej, në procesin zgjedhor të Zgjedhjeve Parlamentare të këtij viti, mbi 70% e ankesave drejtuar PZAP-së kanë ardhur nga organizatat joqeveritare, të cilat kanë mbrojtur të drejtat e votuesve dhe kanë raportuar shkeljet e ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës. Si shembull janë ankesat nga organizatat tjera joqeveritare, të cilat me vendim të PZAP janë pranuar si të bazuara (shihni, për shembull, vendimin Anr. 199/2019, pas ankesës së organizatës joqeveritare “BIRN dhe Interviews Kosova”; vendimin Anr. 20/2019, pas ankesës së organizatës joqeveritare “Instituti Demokratik të Kosovës (KDI)”; vendimin Anr. 329/2019, pas ankesës së organizatës joqeveritare “BIRN”). Askund në përgjigjen e KQZ-së, as në vendimin e PZAP-it, nuk ofrohet asnjë shpjegim se pse këto organizata të tjera janë trajtuar si bartës legjitim të interesave ligjorë, ndërsa organizata GERMIN është përjashtuar prej procedurës pikërisht mbi këtë pikë.

Prandaj, për arsyet e lartpërmendura, përgjigjja e KQZ-së në ankesën tonë në PZAP, përveç se nuk i trajton fare argumentet e organizatës GERMIN për shkeljen e aktgjykimit A.A.UZH.nr. 20/2019 të Gjykatës Supreme, kjo përgjigje e KQZ-së edhe mbështetet në pretendime të pabazuara, të paargumentuara dhe përjashtuese, sepse është më se e qartë që Organizata GERMIN ka interes ligjor në këtë procedurë, njëjtë sikurse organizatat e tjera të shoqërisë civile që e kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave zgjedhore dhe të drejtave të tjera të garantuara me Kushtetutë dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

Vlefshmëria e votave të ardhura përmes postës, e përcaktuar me dy aktgjykime të Gjykatës Supreme, nuk mund të reduktohet në numra, por në parimet mbi të cilat janë vendosur këto aktgjykime. Fakti që në aktgjykimin A.A.UZH.nr. 20/2019 të Gjykatës Supreme pranohet rregullësia dhe vlefshmëria e 4.639 pakove me fletëvotime nuk do të thotë që votat e tjera të ardhura prej momentit kur është bërë ankesa (11.10.2019) dhe deri në fillimin e verifikimit të tyre (31.10.2019), janë të papranueshme.

Përkundrazi, mospranimi i 1806 pakove të fletëvotimeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit, por të cilat kanë arritur pas afatit antikushtetues të KQZ-së, cenon sërish të drejtat zgjedhore të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës dhe parimin e votimit universal. Ky veprim shkel po ashtu edhe parimin e barazisë së votës sipas të cilit, e drejta e votës nuk nënkupton vetëm të drejtën për të votuar por edhe të drejtën e efektit të barabartë të votës me votat e qytetarëve të tjerë të Republikës. Shihni gjithashtu, në këtë drejtim, nenin 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (“Votuesit me të drejtë vote janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar dhe për të hedhur numër të barabartë të votave në zgjedhjet e njëjta”). Duke pasur parasysh që në këtë rast KQZ nuk e ka vlerësuar fare vlefshmërinë e votave në këto 1.806 pako, sepse nuk ka pranuar t’i trajtojë ato, dhe se ligjshmëria e tyre duhet të pranohet në bazë të dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, humbja e votës nuk është aspak e justifikueshme. Rrjedhimisht, mosnumërimi i fletëvotimeve nga këto pako, në mosbindje të plotë ndaj aktgjykimit A.A.UZH.nr. 20/2019 të Gjykatës Supreme, e bën të kontestueshëm gjithë procesin e numërimit të votave dhe cenon integritetin e këtyre zgjedhjeve.

Sipas logjikës së aktgjykimeve të Gjykatës Supreme për votat me postë, të gjitha pakot me fletëvotime të nisura para ditës së zgjedhjeve, të cilat kanë arritur në KQZ deri në ditën përpara procesimit të 4639 pakove për të cilat është ushtruar ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, duhej të procesoheshin së bashku me to. Përkritazi me këtë, 1806 pakot e mbetura me fletëvotime janë po aq të vlefshme sa 4.639 pakot e tjera të numëruara më së fundmi nga KQZ dhe duhet të procesohen, pa vonesë.

Prandaj, kërkojmë nga Gjykata Supreme, që sipas mandatit të saj ligjor, dhe në bazë të katër parimeve të lartcekura të aktgjykimeve AA.UZH. nr. 20/2019 dhe AA.UZH. nr. 19/2019, të ndërmarrë veprime konkrete dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të numëruar 1.806 pakot e mbetura me fletëvotime të ardhura përmes postës.

Singerisht,

Liza Gashi, Drejtoreshë Ekzekutive



OJQ GERMIN